



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.09.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

Mbi

Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30.07.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 10.09.2018, shqyrtoi Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30.07.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat caktoi relator për shqyrtimin e këtij dekreti, Znj. Blerina Gjylameti.

Në mbledhjet e komisionit për të dhënë vlerësimin e Qeverisë mbi Dekretin e Presidentin ishte i pranishëm Ministri i Financave dhe Ekonomisë Z. Arben Ahmetaj

II. Shqyrtimi i Dekretit të Presidentit në komision.

Presidenti i Republikës bazuar në nenin 85, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka depozituar pranë Kuvendit, Dekretin nr. 10850, datë 30.07.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”

Bazuar në nenin 27, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret, është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me cilësinë e komisionin përgjegjës, bazuar në nenit 86, dhe 32-38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë dekret vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës, pra konkretisht shqyrton vetëm çështjet e ngritura lidhur me nenin 6 të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”

Presidenti i Republikës në arsyetimin e tij për kthimin e ligjit, është mbështetur kryesisht në dy elementë si më poshtë:

- Iniciativa nuk përmbush objektivat social të shtetit Shqiptar të përcaktuara në nenin 59 të Kushtetutës.
- Ndryshimet e propozuara janë të pa argumentuara nga ana ekonomike dhe kanë sjellë një ulje/reduktim të barrës fiskale nëpërmjet aplikimit të sistemit të ri të tatimit për bizneset e lojërave të fatit

Për të bërë një analizë më të plotë të këtyre pretendimeve po i analizojmë ato me radhë.

Për sa i përket pretendimit për mos përmbushje të objektivave social, të përcaktuara në nenin 59 të Kushtetutës, vlerësojmë se nuk janë të bazuara pasi Ligji nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk ka në fokus dhe nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me asnjë prej objektivave social të parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës, pasi ky ligj rregullon mënyrën e taksimit të tatimit mbi të ardhurat. Pavarësisht nga kjo në hartimin e tij, siç është evidentuar edhe nga Presidenti, Qeveria dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat, kanë mbajtur në konsideratë disa elementë specifik që lidhen apo janë në vazhden e gjithë lehtësirave dhe politikave e objektivave socialë të Qeverisë siç është reduktimi/ulja e normës së tatim fitimit nga 15% në 5% për biznesin e vogël dhe të mesëm, për fermerët që përfshihen në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor si dhe për ato biznese që operojnë në fushën e agroturizmit.

Neni 6 i ligjit nr. 39/2018, synon riformulimin e paragrafit të dytë të nenit 38 “Dispozita kalimtare” me qëllim saktësimin e përkufizimit të të ardhurave bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojrave të fatit si dhe unifikimin e këtij paragrafi me përcaktimet e tjera të bëra në ligjet e fushës, duke mundësuar zbatimin më mirë të dispozitës dhe për rrjedhojë të ardhura të shtuara në Buxhetin e Shtetit të ardhura këto që do ti shërbejnë ndër të tjera edhe realizimit të mëtejshëm të objektivave socialë dhe reformave të ndërmarra aktualisht nga Qeveria.

Lidhur me argumentin e Presidentit se ndryshimet e propozuara janë të pa argumentuara nga ana ekonomike dhe se ka ulje/reduktim të barrës fiskale nëpërmjet aplikimit të sistemit të ri të tatimit për bizneset e lojërave të fatit përmes përdorimit të konceptit “të ardhura bruto” dhe jo “xhiro vjetore”, e konsiderojmë jo të drejtë për argumentet e mëposhtme:

Rregullimi i marrëdhënieve që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave, bëhet përmes ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, i cili në nenin 4 shkronja “gj” ka përcaktuar, se tek të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, përfshihen ndër të tjera edhe të ardhurat nga lojërata e fatit. Pra ligji organik, që rregullon tatimin mbi të ardhurat, në frymën e tij ka përcaktuar se baza e taksueshme është “e ardhura” dhe jo “xhiroja”. Ky koncept përbën edhe frymën e ligjit në tërësinë e tij dhe për të gjitha llojet e aktiviteteve në mënyrë të unifikuar dhe në këtë kontekst edhe lojërata e fatit duhet “t’i binden” këtij rregulli.

Në vijim të argumentit të mësipërm, theksojmë se edhe vetë ligji organik nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka të njëjtin qëndrim lidhur me normën dhe bazën e taksimit të lojërave të fatit. Kështu, sipas nenit 52, pika 2 të këtij ligji “*Të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit tatohen në masën 15 për qind, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë.*”, ndërsa në nenin 4 pika 40, të po këtij ligji përcaktohet se “*Të ardhurat bruto nga loja*” është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.” Pra siç qartësisht del nga dispozitat e sipërcituara, ndryshimet sipas nenit 6 të ligjin 39/2018, nuk e kanë ulur nivelin e taksimit për lojërat e fatit, ky nivel ishte dhe mbetet 15% mbi të ardhurat bruto.

Në referencë të neneve të sipërcituara të ligjit për lojrat e fatit u shtua në dhjetor të vitit të shkuar paragrafi në pikën 7, të nenit 38, me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit tatohen me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës, ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k.””.

Kjo shtesë që miratua me ligjin nr. 105/2017 dhe u dekretua më pas nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10686, datë 15.12.2017 dhe është e njëjtë në përmbajtje me ndryshimin e bërë në korrik me ligjin 39/2018 (objekt shqyrtimi) po në nenin 38, pika 7, përmes ndryshimit të paragrafit si më poshtë:

“Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15 % mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”

Qëllimi për unifikimin dhe saktësimin e parashikimeve të fundit të kësaj dispozite të bërë me paketën fiskale 2018, në funksion të aplikimit korrekt dhe shmangies së interpretimeve gjatë zbatimit të saj, është evidentuar në relacionin shoqërues të projektligjit dhe ka qënë gjithashtu objekt i diskutimit edhe në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Për gjithë sa më lart, vlerësohet se Dekreti nr. 10850, datë 30.07.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, nuk qëndron dhe si i tillë nuk mund të miratohet nga Komisioni.

Në vijim, Kryetari i komisionit ritheksoi fakti se Dekreti i Presidentit të Republikës në përmbajtjen e tij është i pavërtetë, për disa aspekte si vijon:

Ligji nr. 39/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, nuk ka të bëjë me lojërat e fatit, por qartazi mundëson uljen e tatim fitimit për bizneset e vogla dhe të mesme me xhiro deri në 140 milion lekë në vit duke e çuar nivelin e tatimit nga 15% në 5%, reduktim ky që do të përfitohet nga data 1 janar 2019.

Ligji ka patur fokusin e qartë edhe tek agroturizmi, biznese këto që do të favorizohen në veprimtarinë e tyre që prej 1 janarit 2019, si pasojë e lehtësive fiskale që ky ligj ka përcaktuar. Gjithashtu në fokus të veçantë ky ligj ka patur edhe kooperimin me qëllim rritjen e produktivitetit në bujqësi dhe blegtori, pra fshatin, duke favorizuar këtë aktivitet përmes uljes së tatimit nga 15% në 5%.

Përmes ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, nuk është bërë ulje e normës së tatimit mbi të ardhurat për lojërat e fatit. Definicioni i vendosur nga ligji nr. 39/2018, është i njëjti definicionin i vendosur me ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që për Lotarinë Kombëtare ka rritje të normës së tatimit për të ardhurat e realizuara nga ai aktivitet.

Dekreti i Presidentin realisht ka vetëm një vlerë për këtë komision dhe që konsiston në nxitjen e diskutimit të mëtejshëm për lojërat e fatit. Është evident fakti se që prej vitit 2015, nuk është lëshuar asnjë licence e re për lojërat elektronike të fatit apo dhe në bastet sportive si dhe fakti i mos lejimit të ripërtëritjes së pikave të mbyllura të bastit në një vend tjetër.

Ndryshe nga sa pretendohet në Dekretin e Presidentit, kjo mazhorancë në të gjitha kohërat ka patur një qëndrim shumë të qartë përkundrejt të ardhurave nga lojërat e fatit. Kështu në vitin 2005 niveli i tatimit mbi të ardhurat nga lojërat e fatit ishte 23% për organizatorin e lojërave të fatit dhe mbi 20% për lojtarët. Në vitin 2006, niveli i tatimit mbi të ardhurat u bë 0% për lojtarët dhe 20 % për organizatorin e lojërave të fatit. Në vitin 2008, me aplikimin e taksës së sheshtë, niveli i tatimit mbi të ardhurat u ruajt në masën 0% për individët lojtarë dhe u reduktua në 10% për organizatorin e lojërave të fatit. Në vitet që pasuan 2009-2013, tatimi mbi të ardhurat ka qënë në po këto nivele. Ishte pikërisht viti 2008, viti i rritjes së ndjeshme të kompanive të lojërave elektronike të fatit dhe i kompanive të basteve sportive.

Në vitin 2014, sapo kjo mazhorancë erdhi në pushtet, tatimi mbi fitimin për organizatorët e lojërave të fatit u bë në masën 15%, nivel ky i konfirmuar edhe në vitin 2015 me ligjin e ri për lojërat e fatit si dhe u shtua edhe tatim fitimi mbi të ardhurat në masën 15 % edhe për lojtarët fitues, normë kjo taksimi që mbahet edhe sot.

Për gjitha sa më sipër, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, vendosi mos miratimin e Dekretit nr. 10850, datë 30.07.2018, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Relator

Blerina GJYLAMETI

Kryetar

Erion BRAÇE